



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:065793
Datë: 19.02.2025
Numri i dokumentit: 06872174

C.nr.241/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.G nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat J.I nga Prishtina, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të kundër të paditurës B, me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës, me datë 19.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit B.G nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike.

A r s y e t i m

Paditësi B.G nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati J.I nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës B, me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00euro.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me parashtrësën e datës 06.02.2025, e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës së lartcekur, me arsyetim se në lidhje në këtë çështje me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke pas parasysh edhe tërheqjen e padisë ka ardhur në përfundim se padia e paditësit të konstatohet e tërhequr në kuptim të nenit 261 parag. 1 të LPK-së, i cili e përcakton se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi...”*.

Nga arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387 parag. 1 pika c) të LPK –së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,
C.nr.241/2024, me datë 19.02.2025.

Gj y q t a r i
Avni Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, konform nenit 261.4 të LPK-së.